



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-015

Prishtinë, më 3 maj 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 3 MAJ 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ibrahim Makolli, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 prill 2011,
2. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave,
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 prill 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 prill 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi t'i mbajë dy mbledhje plenare në fillim të këtij muaji.

Mbledhja plenare, më 5 maj 2011, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

Mbledhja plenare, më 6 maj 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Ratifikimi i Marrëveshjes për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore të 11 marsit 2011,
2. Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe UNCTAD (Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për projektin softueri ASYCUDA),
3. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastrë në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim,
4. Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe KfE- Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjetës Regional-Prishtina,
5. Ratifikimi i Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut,
6. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim,
7. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, të mbështetur nga deputetë të tjerë,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2010,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2010, dhe
10. Shqyrtimi i Raportit i punës të Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2010.

3.1 Propozimi i Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Propozimin e Komisionit për përzgjedhjen e anëtarit dhe të kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

3.2 Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me vizitën e realizuar në Shqipëri

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, të realizuar në Republikën e Shqipërisë, prej datës 14 deri më 15 prill 2011.

Pikat shitesë:

1. Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që, në bazë të nenin 100.4 të Ligjit nr. 03/L-241 për prokurimin publik në Kosovë, t'i caktojë tre gjykatës për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur, që do të emërohen nga Kuvendi, për përzgjedhjen e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

2. Lejimi i shpenzimeve për vizitën e delegacionit të një Grupi parlamentar britanik të Unionit Ndër-Parlamentar, më 13 – 15 qershor 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë çështje, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohen shpenzimet e akomodimit, të ushqimit dhe të transportit lokal për një grup parlamentarësh britanik, të Unionit Ndërparlamentar, që do ta vizitojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës, prej 13 – 15 qershor 2011.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi të një grupi të deputetëve

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë çështje, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi i tre deputetëve të Kuvendit të Kosovës nga Grupi Parlamentar “6+”, në Turqi, prej datës 7 deri më 10 maj 2011.

4. Kërkesë e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për krijimin e kushteve të punës

Kryesia diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart dhe konstatoi se duhet të specifikohet kërkesa e Komisionit dhe të procedohet në mbledhjen e radhës të Kryesisë, për të vendosur lidhur më të.

Të ndryshme

Nënkryetari i Kuvendit, **Sabri Hamiti**, paraqiti dy çështje: a) Qëndrimeve që merren në Kryesinë e Kuvendit lidhur me ndonjë çështje të caktuar, ndodhë të mos u përmbahen edhe në punimet e mbledhjeve plenare, b) Në kohën e paraparë për deklarime jashtë rendit të ditës, që është vetëm për deputetë, po u jepet fjala edhe kryeministrit apo zëvendësministrave a ministrave, të cilët po bëjnë replikë me deputetë, por nuk po u jepet fjala deputetëve për të replikuar. Diskutimi i plotë është dhënë në Transkript.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën **12:10** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.